



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

### Procesverbal 07/2024

I Mbajtur në takimin e VII-të të rregullt të KK-së me datën 31.07.2024, në sallën e Kuvendit në ora 10<sup>00</sup> nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtarës për informim.

### Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e VII-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

#### Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të KK-së;
4. Raporti financiar për periudhën Janar - Qershor 2024;
5. Raporti i Auditimit për Pasqyrat financiare për Vitin 2023 Komuna e Ferizajt;
6. Raport i Komisionit lokal për vlerësimin e dëmeve;
7. Propozim -Vendim për Aprovim të Statutit aktual të QKMF-së, të Vitit 2016 si dhe Draft-Statutin Unik të QKMF-së të adaptuar me specifika të QKMF- së në Komunën e Ferizajt;
8. Propozim - Vendim për Aprovimin e Draft Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal të Komunës së Ferizajt për periudhën kohore 2024-2034;
9. Propozim -Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrës kadastrale 626-2 Z.K.Babush i Ri;
10. Propozim -Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurt të objekteve të institucioneve Parashkollore – Çerdheve;
11. Propozim - Vendim për Shpallje Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 2435-1 dhe 2435-2 Z.K.Ferizaj, pronë private, me qëllim të këmbimit pjesën e parcelës kadastrale 180-10 Z.K.Talinovc i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt;
12. Propozim -Vendim për Shpallje interes i përgjithshëm pjesës së ngastrës kadastrale 721-0 Z.K. Nekodim me sipërfaqe 1426 m<sup>2</sup> pronë private;
13. Propozim -Vendim për rishqyrtimin e Vendimit me Nr. 01.Nr. 52 të datës 30.05.2024;

14. Propozim - Vendim për Plotësimin dhe ndryshimin e vendimit Nr. 01.Nr.33 të datës 30.04.2024;
15. Pyetje dhe kërkesa dhe
16. Të ndryshme.

### **Pikat shtesë**

1. Propozim ndryshim i vendimit për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033.
2. Propozim – Vendim për emërtimin e Sheshit “ Adem Demaçi”
3. Propozim – Vendim për bartjen e asetit (Fabrikës së ujit) në Talinoc të Muhaxherëve , Kompanisë rajonale të ujësjellësit “Bifurkacioni”.
4. Propozim –Për hapjen e rrugës “Beqa” në rrugën “Rexhep Bislimi”,

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Pasi përshëndeti të pranishmit ju uroi mirëseardhje në mbledhjen e 7-të të rregullt dhe pastaj e propozoi këtë rend dite të lartë cekur, sa i përket konfirmimit të pjesëmartjes unë nuk kam ndonjë informacion për ndonjë mungesë.

Sa i përket rendit të ditës, në KPF jemi dakorduar që të jenë edhe 3 pika shtesë të cilat janë të lartëcekura dhe pasi u hodhën në votim, rendi i ditës kaloi me të gjitha votat për.

Dhe më pas Kryesuesi e lexoi edhe njëherë të gjithë ftesën me rend të ditës dhe pyeti nëse ka dikush diçka për të shtuar rreth këtyra pikave?

Sa i përket rendit të ditës fjalën e mori Flamur Istrefi, i cili përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe theksoi se pika e 12-të është hjekur në KPF desha ta theksoi.

**Arbër Bytyqi** - Propozoi një propozim të ri që është bartja e asetit të fabrikës së ujit në Talinove të Muhaxherëve.

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Theksoi se pika e 12-të është hjekur nga rendi i ditës në KPF, gjithashtu edhe pika e 6-të, pra raporti duhet të hjeket pasi komisioni nuk e ka plotësu si duhet dhe e paraqesim në seanca tjera.

Kush është për këtë rend të ditës, pra me hjekjen që u ceken dhe me atë që u shtuan dhe kaloi me të gjitha votat për, pra miratohet rendi i ditës.

Sa i përket procesverbalit a ka ndokush ndonjë vërejtje apo diçka për të shtuar pyeti Kryesuesi, dhe pasi nuk pati e hodhi në votim dhe kaloi me të gjitha votat për.

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Lexoi pikën e 4-të dhe ia kaloi fjalën drejtoreshës së Financave e cila e lexoi raportin ashtu si ka qenë në dokumentin e paraqitur për asamblenë.



**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – E lexoi pikën e 5-të që ka të bëjë me Raportin e auditimit dhe e hapi debatin.

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Hapi debatin për këtë pikë dhe ia kaloi fjalën :  
**Brahim Osmanit** - I cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit theksoi:

Faleminderit Kryesues;

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal;

Përfaqësues të mediave;

Të dashur qytetarë:

Sot para nesh e kemi një dokument që tregon gjendjen kritike për të ardhmen e Komunës sonë, Raportin tronditës të Auditorit për Vitin 2023.

Ky raport për fat të keq është dëshmi e qartë e keqmenaxhimit, injorancës dhe shpërdorimit të fondeve publike nga ekzekutivi ynë, jo që nuk e kemi ditur, por ky është thjesht një dëshmi më shumë që duhet të na brengosë ende.

Raporti zbardh një sërë shkeljesh që nuk janë të izoluara, por janë pjesë e një problemi më të madh dhe më të thellë të qeverisjes së dobët, e të uritur për t'u pasuruar nga paratë e qytetarëve tanë.

**Zyra Kombëtare e Auditimit**, ka nxjerrur opinion të kualifikuar për të disa vit radhazi, duke na ndaluar automatikisht për të fituar grantin e performancës. Ky është tregues i qartë i dështimit total të ekzekutivit për të menaxhuar financat dhe për të respektuar standardet bazë të administrimit. Pyetja që lind është: A janë në gjendje këta njerëz të kuptojnë se çfarë po bëjnë? Apo janë kaq thellë të zhytur në injorancën e tyre?

Çfarë ka gjetur Auditori është alarmante. Paramendojeni, Komuna jonë ka hyrë në obligime kontraktuale në vlerë prej 2,326,548€ pa fonde të mjaftueshme financiare.

Ky është veprim që tregon mungesë totale të planifikimit dhe një nivel të lartë të injorancës financiare. Ose për më keq, të tilla veprime tregojnë për ndërlidhjen me kompanitë me të cilat fitojnë së bashku nga paratë e taksapaguesve.

Si mund të udhëheqë ky ekzekutiv kur nuk janë në gjendje të bëjnë një planifikim të thjeshtë financiar e nuk e dinë se nuk mund të shpenzosh më shumë se që ke para? Apo janë mësuar sikur në jetën private të jetojnë e të shpenzojnë nga dhuratat e biznesmenëve?

Prandaj edhe Auditori ka gjetur se qeverisja Aliu ka kontraktuar shërbime përmes procedurës së hapur të prokurimit me operatorë ekonomik privat për shërbime që mund të ofrohen nga ndërmarrjet publike komunale. Madje nuk po flasim për çfarëdo vlere, por për plot 1.6 milion euro.

Kjo është dëshmi e qartë e shpërdorimit të fondeve publike dhe favorizim direkt i operatorëve privatë në dëm të ndërmarrjeve tona publike. Në vend që të mbështesin dhe forcojnë ndërmarrjet

publike, ju po i dobësoni ato edhe më shumë e po i rrezikoni qindra familje për të mbetur pa të ardhura. Nuk e di si mund të jeni kaq të pavetëdijshëm për pasojat e këtyre veprimeve?

Më tej Auditori ka konstatuar se gjatë vitit 2023, Komuna nuk kishte regjistruar 31 të punësuar në listën e pagave, të cilët kishin kontrata të rregullta të punës. Kjo tregon mungesë të thellë të profesionalizmit dhe keqmenaxhim flagrant të burimeve njerëzore. Si mund të presim që ky ekzekutiv të menaxhojë komunën kur nuk janë në gjendje të menaxhojnë listën e pagave të punonjësve të tyre? Apo vetëm po u thuani njerëzve që po u punësojmë, pastaj për paga ia bëni disi. Ndoshta edhe ua jepni nga xhepi.

Sepse juve nuk ju dhimbsen paratë publike. Për shkak të vonesave tuaja të qëllimshme në pagesën e detyrimeve financiare, ju keni paguar shpenzime shtesë në vlerë prej 254,260€ tek përmbaruesi. A keni kufi ju? A ndaleni ndonjëherë të thuani mos e kemi stërtepruar?

Si mund të justifikoni pagesa 250 mijë euro për vonesa në pagesa?

Si mund të jeni kaq të dëmshëm? Auditori ka treguar se ju keni iniciuar procedurat e prokurimit pa projekte të duhura të ndërtimit. Ky veprim tregon mungesë serioze të planifikimit që çon në rritje të kostove dhe probleme në zbatimin e projekteve. Si mund të filloni projekte pa një plan të qartë? Kjo është një dëshmi e qartë e diletantizmit në menaxhimin e projekteve. Ju as pas të gjitha këtyre viteve nuk i keni mësuar as procedurat elementare të menaxhimit por i keni perfeksionuar metodat e hajnisë. Ne jse Auditori po ua çmonton. Edhe Prokuroria s'do t'ju mbrojë edhe shumë gjatë!

Unë nuk e di si po mund t'ju mbrojë edhe tash kur në katër raste, ju keni ndryshuar kontrat duke tejkaluar limitin e lejuar ligjor prej 10%. Në një kontratë keni shkuar deri në 46%.

Edhe a mund të më tregoni a jeni të vetëdijshëm që ka ligje apo kaq të paprekshëm mendoni se jeni? Në 10 pagesa në vlerë 547,842€, është konstatuar se komuna ka përdorur fonde nga projektet për qëllime tjera nga ato për të cilat ishin planifikuar. Ky është shpërdorim i fondeve publike dhe injorancë e skajshme për të cilën s'ka pasur nevojë të na tregojë Auditori sepse ju njohim mirë.

Këto

Ju keni lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizim të aktiviteteve në fushën e zhvillimit ekonomik duke iu shmangur procedurave të prokurimit. Kjo tregon mungesë të transparencës dhe favorizim të operatorëve ekonomik. Nuk është e çuditshme për punën tuaj në prokurim sepse ju i hapni tenderat sot për sot. Ne jse ju i hapni po pastaj nuk i hapni. Sepse, ju dështojnë!

Ju keni financuar OJQ duke iu shmangur thirrjes publike për financimin e OJQ-ve. Pse ky favorizim? Çfarë interesash fshihen pas këtyre veprimeve? A po i ndërsoni kundër njëri-tjetrit me pare të qytetarëve apo si është puna?

Të gjitha këto shkelje janë dëshmi e qartë e dështimit të plotë të ekzekutivit të Komunës së Ferizajt për të menaxhuar financat dhe burimet e saj në mënyrë të duhur. Ky raport i Auditorit është thirrje për veprim urgjent nga Prokuroria dhe për llogaridhënie. Prokuroria duhet t'i hetojë këto shkelje dhe të marrim masa për të parandaluar përsëritjen e tyre në të ardhmen sepse të tilla keqpërdorime



keni bërë edhe më parë. Pra ju nuk mbusheni mend por gjykata duhet t'ua mbushë Aktgjykimin për fajësi.

Është koha që të mbaheni përgjegjësi për këto shkelje dhe që financat publike të menaxhohen me profesionalizëm, transparencë dhe respekt për ligjin. Vetëm kështu rikthehet besimi i qytetarëve në institucionet tona të cilat i keni degraduar kaq shumë e kaq keq. Sepse të tillë jeni. Të pangopur e pandjenja për besimin që keni marrë.

E turpshme!

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Pastaj ia kaloi fjalën Flamur Istrefit i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi:

**Raporti i auditorit të përgjithshëm**, për pasqyrat financiare të Komunës së Ferizajt për Vitin 2023, është raport me te gjetura shqetesuese, i cili si edhe në vitet e kaluara ve ne pah dështimet e shumta që e kanë karakterizuar qeverisjen lokale gjatë vitit të kaluar, dështime për të cilat kemi reaguar edhe ne si subject, e që ky raport vetëm sa e ka konfirmuar që kemi pasur të drejtë në kritikën tona.

Duhet theksuar, që edhe këtë vit kemi Opinion të kualifikuar, i cili vjen si pasojë e mos planifikimit të duhur dhe si i tillë tregon për keqmenaxhim dhe keqperdorim të parase publike nga ana e pushtetit Lokal.

Te gjeturat e këtij raporti, të cilat janë bazë për opinion të kualifikuar, tregojnë për: prezantim jo të saktë të detyrimeve të papaguara në vlerë 80 mijë euro, për prezantim jo të sakte të llogarive të arketueshme në vlerë 127 mijë euro, për prezantim jo të saktë të detyrimeve kontigjente në vlerë prej 2 milion e 600 mijë euro, prezantim jo i saktë pasurive për shkak të nënvleresimit në vlerë 192 mijë euro si dhe keqklasifikim të shpenzimeve në Kategori në vlerë prej 787 mijë e 464 euro.

Një nga çështjet kryesore që theksohet nga Auditori nga viti në vit, e për të cilin kemi ngritur shqetesimin tonë në vazhdimësi, është Çështja B6, që tregon për dobësitë në menaxhimin e obligimeve dhe shpenzimet shtesë përmbarimore. Pra, edhe gjatë Vitit 2023, për shkak të vonësave në kryerjen e obligimeve financiare, janë shkaktuar shpenzime shtesë përmes proceseve gjyqësore/përmbarimore.

2 milion e 400 mijë euro janë marr nga përmbaruesit, e prej tyre 254 mijë e 260 euro janë vetëm shpenzime shtesë të realizuara për proceset kontestimore/përmbarimore.

Kjo nuk është e vetmja, gjatë Vitit 2023 thesari kishte ekzekutuar përmes procedurave përmbarimore vlerën prej 2 milion e 768 mijë, prej të cilave shpenzime të interesit dhe përmbarimit ishin 614 mijë e 835 euro (kjo për kontratën kolektive)

Pra, brenda një viti, për shkak të keqplanifikimit, nepermjet përmbaruesit, komunes së Ferizajt në total i janë marr rreth 5 milion e 200 mijë euro, e prej tyre vetëm interes e procedura përmbarimore 870 mijë euro.

Ndërkohë, që po ti mbledhim edhe vitet e kaluara, del që brenda 3 viteve, komunes tone i janë marr rreth mbi 15 milion Euro nga përmbaruesit, e vetëm për interes dhe procedura përmbarimore komuna e Ferizajt ka paguar rreth 2 milion Euro.



Pra, kemi te bejme me nje qeverisje lokale e cila, qellimshem, i ka fal 2 milion euro te taksapaguesve ferizajas, para me te cilat Po te kishte planifikim te duhur, shume me mire do te ishte Qe te ishin kthyer ne investime ne te mire Te qytetareve. 2 milion Te humbura, per te cilat askush nuk jep pergjegjesi.

Po ashtu, ceshtje tjeter me rendesi, eshte Çështja A1, qe tregon per prezantim Jo te sakte Te detyrimeve Te Pa paguara ne pasqyra vjetore financiare. E gjetura ne kete ceshtje, tregon se komuna nuk i kishte raportuar detyrimet e papaguara ne vlere prej 80 mije e 60 euro per pagat e 31 punonjesve ne Arsim, te cilet nuk ishin regjistruar ne listen e pagave.

Duhet theksuar qe edhe gjate Vitit 2022 kemi pas 18 punonjes jashte listes se pagave, e gjate vitit 2023 eshte rritur numri Duke tejkualuar numrin e lejuar te punonjesve me ligjin e buxhetit, e qe i bjen qe komuna ka hyr ne obligime pa buxhet ne momentin Kur ka angazhuar 31 mesimdhenes te cilet jane pranuar me procedura te rregullta te rekrutimit, e te cilet nuk jane futur ne listen e pagave, e rrjedhimisht nuk kane marr paga. Krejt kjo, ndikon qe te demtohet buxheti I komunes, pasi qe keta punonjes do ti drejtohen permbaruesve per te realizuar te drejtat e tyre e qe pastaj do te kete kosto shtese per interes dhe procedura permbarimore

Çështje tjeter me rëndesi është Çështja A2 që thekson: hyrjen në obligime kontraktuale Pa fonde te mjaftueshme, si dhe nënshkrimi i kontratës për Projekt të pa planifikuar me ligjin e buxhetit. Këtu kemi të bëjmë me 7 raste, ku komuna ka hyr në obligime financiare pa fonde të mjaftueshme, në kundërshtim me Ligjin për ndarjet Buxhetore dhe Kornizen Afatmesme te shpenzimeve: Në rastin e parë Komuna ka lidh kontratë për rregullimin e shtreterve të lumenjeve dhe kanaleve ujore në Talinovec, Koshare, Tern, Pleshine, Greme dhe Gacke në vlerë Të parashikuar prej 540 mije eurove, a kishte fonde të ndara për Vitet 2023-2025 vetëm 250 mije euro. Pra, përkunder mungesës së Buxhetit, komuna ka hyr në obligime pa mbulesë buxhetore 290 mije euro.

Njejtë është edhe te rikonstruimi i rrugeve të reja në fshatrat Tern-Lubovec, Nerodime, Rakaj , Manastirc, Bibaj, Gacke, Prelez, Rahovice, Greme, Komogllave Ku komuna ka lidhur kontrate kornize me vlere te parashikuar prej 1 milion Euro, ndersa sipas Ligjit per ndarjet Buxhetore te vitit 2023, per 3 vite kishte ndare 550 mije euro. Pra, per kete Projekt, komuna ka hyr ne obligime kontraktuale pa mbulesa buxhetore prej 450 mije euro.

Po ashtu komuna kishte lidh kontrate për projektin ndertimi i infrastruktures turistike ne fshatin Jezerc, ne dy llote ne vlere prej 791 mije euro. Vlen te theksohet, se për këtë Projekt nuk kishte fonde te ndara sipas ligjit te ndarjeve buxhetore per vitet 2023,2024 dhe 2025. Keshtu pra, komuna ka hyr ne obligime kontraktuale pa mbulesa buxhetore, ne vlere prej 791 mije euro. Hyrja ne obligime ne nje forme te tille, Pa siguruar fondet e nevojshme, automatikisht ndikon në rritjen e obligimeve te papaguara dhe shpenzimeve te permbarimit dhe në te njejten kohe eshte anashkalim i i Ligjit te buxhetit dhe vendimeve te ketij Kuvendi. Arsyet se pse duhet te funksionoj kjo qeverisje në kundërshtim me ligjin e buxhetit, vendimet e ketij kuvendi dhe planifikimet e veta, i di me Se miri kryetari, i cili këto projekte i'a jep në vazhdimësi operatoreve te njejte te cilet tashme kane krijuar monopol në komunën tone.

Çështja B7 ka te bejë me mungesen e projekteve ekzekutuese. Gjate vitit 2023, komuna e Ferizajt ka filluar procedurat e prokurimit dhe ka lidhur kontrata per projekte pa u hartuar paraprakisht projektet ekzekutive. Rasti konkret, ka te bej me: Meremetimin e aneksit te shkolles fillore ish Shaban Hashani - faza e dyte në vlere 327 mije e 552 euro. Projekt tjeter eshte: Ndertimi i silloseve për ruajtjen e grurit me vlere 999 mije euro..



Pra, Projekte milionesh Pa Projekte ekzekutuese, te cilat pastaj ndikojne në realizim te dobet te kontratave si dhe mund te shkaktoj shpenzim te pa parashikuar apo vlere te dobet per parane e shpenzuar. Duhet theksuar, se inicimet e procedures se prokurimit në mungese te projektit ekzekutues apo leshimet qe ndodhin në zyren e prokurimit nuk jane te rastesishme, jane te qellimshme, duke marr parasysh qe kemi në krye te saj nje zyrtare me aktakuze e ku nje numer i madh i tendereve dyshohet se rregullohet paraprakisht.

Këtë qe po e them per zyren e prokurimit, ma perforcon Çështja A4 m, qe tregon qe ka pasur shmangje te procedurave te prokurimit me rastin e marrveshjes me organizaten Jo qeveritare Agjensioni i Zhvillimit Rajonal-Lindje.

Komuna e Ferizajt, duke anashkaluar procedurat e Prokurimit, kishte nenshkruar marrveshje bashkepunimi me kete OJQ per angazhimin e stafit në cilesine e konsulenteve, perkatesisht ekipit per projekte me interes për komunën. Vlera e kesaj marreveshje ishte 30 mije e 768 euro, e qe per kete Marrveshje nuk kishte emeruar as menaxher te kontrates sikurse kerkohet me ligjin në fuqi. Kjo forme e kontraktimit, e demton konkurrencen, transparencen e procesit e Po ashtu rrit rrezikun e humbjes financiare të komunës. Forma e tillë e marrëveshjeve pa konkurrence, zakonisht jepet per dosta te pushtetarev te cilet pastaj jane drejtperdrejte e sherbim te tyre.

Njejtë si Çështja A4, eshte edhe Çështja A5, e cila thekson se financimi i organizatave jo qeveritare nuk eshte ne pajtim me rregulloren e MF

Pra, behet fjale per nje Memorandum te Mirekuptimit me Organizaten Jo-qeveritare Play International, qe ka lidhur komuna e Ferizajt në vlere 8 mije e 526 euro, lidhur me zbatimin e projekteve arsimore, duke e anashkaluar thirrjen publike per financimin e ketij projekti. Favorizimi i kesaj OJQ-je është padrejtesi për OJQ-te e tjera të cilat nuk e kanë pasur mundësinë as që të aplikojnë për shkak se nuk është hapur thirrja fare.

E gjetur me rëndësi është edhe Çështja B11 qe tregon për vonesa në realizimin e kontrates.

Jane dy raste qe duhet permendur. E para ka te bej me ndertimin e kabinave per pritjen e udhetareve ne vendqendrimet e autobuseve ne vlere 33 mije e 203 euro, e cila eshte nenshkruar në maj te vitit 2022 dhe afati për perfundimin e te gjitha punimeve ishte 12 muaj. Në vend që të përfundohej komplet projekti për afatin e caktuar 12 mujor, janë kryer vetem 38% e punimeve dhe për vonesat në realizimin e kontrates, komuna nuk ka aplikuar penale siç parashihet me kontratë.

Rasti tjetër ka të bëjë me ndertimin e sallës së sportit në Fshatin Balaj, në vlerë 270 mijë e 185 euro, i cili kishte filluar punimet në shtator te vitit 2018 dhe afati per perfundimin e te gjitha punimeve ishte 2 vite, por deri në Qershor të Vitit 2023 Ende nuk ishin perfunduar. Pra projekti qe eshte dashur te perfundoj për dy vite, në vitin 2020, akoma në qershor te vitit 2023 nuk ka perfunduar, pra as pas 5 viteve

Situatën më shqetësuese e bënë edhe mungesa e progresit në zbatimin e rekomandimeve që janë dhënë pas auditimit në vitin 2022. Në raportin e sivjetshëm theksohet, ritheksohen se në vitin 2022 Komunës së Ferizajit i ishin dhënë nga auditori plot 19 rekomandime. Por, nga to vetëm 6 janë zbatuar, kurse 13 jo. Pra, nuk janë zbatuar as 30% e rekomandimeve.

Po flasim për një gjendje të përsëritur, për gjetje që nënvizojnë parregullësi financiare që dëmtojnë buxhetin e interesin qytetar. Derisa në anën tjetër kemi një barrikadim nga qeverisja komunale, që reziston t'i zbatojë rekomandimet dhe refuzon ta përmirësojë gjendje

Duhet duhet theksuar se te gjeturat e Auditorit, jane vetem nje pjese e vogel keqperdorimeve qe behen ne komunen tone.

Dëmtimi i buxhetit për shkak të keq planifikimit, leshimet e qellimshme në zyre të prokurimit, tejkalimi në kontrata të limitit Ligjor të lejuar, pagesa të projekteve nga buxheti i projekteve tjera, shmangja e procedurave të prokurimit, prezantimi jo i sakte i detyrimeve të papaguara, prezantimi jo i sakte i detyrimeve kontigjente, klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve, hyrja në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme si dhe mos zbatimi i rekomandimeve do duhej të ishin baze të mjaftueshme për prokurorinë për të filluar hetimet në mënyrë që demtuesit dhe keqperdoruesit të parase publike të cilet e demtojnë buxhetin e komunes me miliona euro të dalin para drejtësisë.

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Ia kaloi fjalën Verona Isakut e cila pasi përshëndeti të pranishmit theksoi:

Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë!

Jemi mesu tu e degju Kryetarin e komunes qysh me gojen plot flet për llogaridhënie e transparencë, e sahere që del Raporti i auditimit na tregon që pushteti juaj veç llogaridhenes e transparent nuk është, pra për informacion të juaj edhe të qytetareve ju keni bërë prezantim jo të sakte për vlerën mbi 3 milion euro, e arsyjen e deklarimeve jo të sakta e dini veç ju.

Kryetar populli thotë shtrij këmbët sa të mrrin jorgani, e t'i ke shku e ke hy në obligime për vlerën 2,326,548euro pa pas pare e pa e ditë edhe qysh do me i siguru ato pare. Ju mbaj mend që çdo raport e keni akuzu qeverisjen e kalune qysh ju ka lane borgje e me kete veprim jeni tu bo edhe ma zi.

Fatin e Kompanisë “Pastërtia” e punëtorëve aty e kena ngrit vazhdimisht si çështje, e t'i në vend se me u mundu me ju bo zgjidhje t'i ke shku ke kontrakti kompani të tjera private për punet që ka mujt me i kry “Pastërtia”, e sot edhe pse prap je tu operu me 3 kompani, prap qytetin e ke kthyer në deponimbeturinash.

Edhe gjatë vitit të kaluar në proceduar permbarimore i keni shpenzu 254,260euro, që marrim shembull me pas qene ju pak ma të pergjegjshem, keto pare kishim mujt me I dhane për objektin e shkollës Gjon Serreci që është në gjendje të tmerrshme.

Ke inicuar procedure të prokurimit pa pas projekt të detajizum se çka po don me bo, pra na kafe nuk dalim me pi pa e caktu kafeterinë se ku po shkojme, e ti inicon procedur të prokurimit pa e dit se ku do me dal dmth kaq banal jeni.

547,842euro është vlera që ti në kete kuvend I ke votu për dicka tjeter e I ke shpenzu për diçka tjeter, pa kry asnje procedur të rialokimit ose ridestinitimit, pra kjo tregon për arrogancën e juaj në qeverisje, pra ju mendoni se ktu jeni në toke të babes edhe mundeni me bo bash çka të doni, po e keni shume gabim.



Ke lidh kontratë 30.768euro pa asnje procedure te prokurimit.

Ke financu OJQ per 8526euro pa thirrje publike per financim, e kete avaz te njejt jeni tu e vazhdu, drejtoresha juve nuk eshte tu u ndal bile tash ka fillu me e nderu edhe kunatin e vet.

I ki 13 rekomandime te auditorit qe as nuk gajlohesh me I permirsu, dmth vazhdimisht I ki te gjeturat e njejta edhe vazhdon prap mos me I apliku

Kryetar, ne po e shohim se je dorezu, pe shohim qe nuk po gajlohesh per qytetaret, pe shohim qe jeni tu u mundu me zhvat me te madhe kete pushtet, pe shohim qe jeni tu e pa se e keni trenin e fundit, mirepo eshte mire pushtetin me lane si ni kryetar krenar, por jo duke u shprehur ne gjuhen qe ju e flisni dhe e kuptoni, te largoheni si I mjere.

Faleminderit

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Ia kaloi fjalën asambleistit Besim Haziri i cili pasi përshëneti të pranishmit theksoi se po thuajse të gjithë i thanë koleget mua më bëjnë më së shumti përshtypje çështjen a3 dhe a5 ku te a3 kemi të bëjmë me një kontratën mbi 1.6 milion euro këtu komuna nuk e ka patur parasysh që komuna ka dy ndërmarje komunale të cilat mund ti kryejën ato punë që i ka kontraktuar me operator ekonomik të jashtëm dhe kjo jo veç që ndikon në aspektin financiar të komunës dhe ajo i ka marrë nga operator me qmim shumë më të lartë dmth jemi tu folë për 1.1 milion euro më shumë që të njejtat punë i ka kryer ndërmarja publike dhe këtu mund të ngrem dyshime për keqpërdorime sikur tju kish dhanë kompanive të komunës ato edhe do të fuqizoheshin ne të gjitha aspektat këtu kanë brum edhe për prokurorin edhe për krimet ekonomike qështje tjeter ka të bëjë në hyrje në obligime më shumë pra përmes ngritjeës së puntorve këta puntor nuk mund të hyjnë në listë të pagave pra mungesat me arsye dhe pushimet e leonis dhe shume faktor dhe këto vonesa të pagesave rrisin shpenzimet edhe përmbarimore ku dihet që në këto 3 vjet sa ka rritje vetëm të përmbaruesit pra komuna jonë ka zgjedh përmbaruesit si mjet pagese kjo punë është bërë si trend në qytetin tonë ju faleminderit

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Më pas ia kaloi fjalën Yllka Nezirit e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit theksoi se:

Ne kemi pranuar raportin nga zyra kombëtare e auditimit për auditimin e Komunes së Ferizajt.

Qe nga Viti 2020 çdo vit opinionin e auditimit të Komunës së Ferizajt është opinion negativ.

Prezantim jo i saktë i detyrimeve të papaguara në PVF në vlerë prej 80,060€.

B1 Prezantim jo i saktë i llogarive të arkëtueshme në PVF në vlerë prej 127,975€.

B2 Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontigjente në PVF në vlerë prej 2,600,648€.

B3 Prezantim jo i saktë i pasurive në PVF, për shkak të nënvlerësimit për 192,138€, duke bërë që vlera e pasurive kapitale dhe jo kapitale të mos jetë e shpalosur saktë në PVF.

B4 Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë 787,464€.

Komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale në vlerë prej 2,326,548€ pa fonde të mjaftueshme financiare.

A3 Komuna kishte kontraktuar shërbime përmes procedurës së hapur të prokurimit me operator ekonomik privat për shërbime të cilat ofrohen nga ndërmarrjet publike komunale.

Si pasoj e ketyre keqmenaxhimeve gjendja e kompanive publike është në gjendje jot e mirë financiare dhe dite e me shume po po perballen me telashe per shkak te mos mbeshtetjes nga komuna e Ferizajt.

B5 Komuna gjatë vitit 2023, nuk kishte regjistruar 31 të punësuar në listën e pagave, të cilët kishin kontrata të rregullta të punës.

B6 Si pasoj e vonesës në pagesën e detyrimeve financiare komuna ishte detyruar të paguante shpenzime shtesë në vlerë prej 254,260€ në emër të procedurës kontestimore/përmbarimore apo interesit për pagesë të vonuar.

B7 Komuna kishte iniciuar procedurat e prokurimit pa një projekt detal (ekzekutiv) të ndërtimit.

B8 Në katër (4) raste, komuna kishte bërë ndryshime të kontratave duke tejkaluar limitin e lejuar ligjor prej 10%.

B9 Në 10 pagesa të testuara në vlerë 547,842€, kemi identifikuar se komuna ka përdorë fondet nga projektet për qëllime tjera nga ajo për të cilin ishin planifikuar, pa i zbatuar procedurat dhe kriteret për transferim dhe rialokim të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër.

A4 Komuna kishte lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e aktiviteteve në fushën e zhvillimit ekonomik me vlerë prej 30,768€, duke iu shmangur procedurave të prokurimit

A5 Komuna kishte financuar OJQ me vlerë prej 8,526€ duke iu shmangur thirrjes publike për financimin të OJQ-ve.

Përveç keqmenaxhimit dhe keqklasifikimit dhe shkeljeve ligjore, opinioni i kualifikuar e përjashton komunën e Ferizajt nga marrja e donacioneve nga organizata ndërkombëtare dhe nga granti i performancës, ku qytetarët e Ferizajt privohen dhe nuk përfitojnë projekte infrastrukturore, projekte të cilat do të përmirësonin kushtet dhe cilësinë e jetës

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Pyeti nëse ka dikush për të shtuar lidhur me këtë pikë dhe pasi spati i njoftoi kuvendarët se pika e 6 është hjek nga rendi i ditës në KPF dhe vazhdoi me pikën e 7 pra aprovimi i Statutit të QKMF-së dhe ia kaloi fjalën Drejtorit Kemajl Emimi i cili e e laboroi pikën e 7-të si në propozim dhe i ftoi të pranishmit që ta përkrahin, më pas fjalën e mori Adnan Selmani i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se po ipët një mundësi e mirë QKMF-së dhe ne si grup i VV jemi për këtë statut dhe pasi spati të interesuar për aprovim dhe u hodhë në votim dhe kaloi me 32 vota për dhe 4 kundër.

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – E lexoi pikën e 8- të dhe theksoi se e kemi kaluar në diskutim publik dhe pasi mori fjalën Drejtori Balton Dërguti dhe njoftoi që kemi bërë plotësimet e tëra si i ka kërkuar ministria dhe të gjitha ndryshimet i keni në propozim dhe si e tillë kaloi më të gjitha votat për.



**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Lexoi pikën e 9- të dhe pasi spati të interesuar për diskutim u hodhë në votim dhe kaloi me 29 vota për, 0 kundër dhe 2 abstenime.

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Lexoi pikën e 10-të dhe ia kaloi fjalën Drejtorit Afrim Llabjani, i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se këtë temë e kemi diskutuar disa herë dhe kërkohet një zgjidhje pasi që të njejtat herë pas here janë jo funksionale në aspektin e funksionimit të mirëfillt qoft me operator kontraktues si KARITAS-i për shkak të kontratave apo probleme të tjera dhe ne kemi menduar që si zgjidhje e mirë do të ishte ipja e objekteve për shfrytëzim ashtu si është në propozim.

**Brahim Osmani** - Pasi përshëndeti të pranishmit, theksoi se për që ky propozim as su dasht me ardhë në kuvend, po shihet edhe nga anëtarët e pozitës që e lëshun sallën, unë veç po du me vet drejtorin cilit dost doni meja dhanë, ju e keni parashiku që me KARITAS me punësu në fshatin Greme, thojshi spo na len ministria me punësu, për këtë ka mbet çerdhja në Fshatin Greme, tash po dalka propozimi që me KARITAS me punësu në Fshatin Greme, pra ju keni ba hajgare me fshatin me të madh në komunë. Pra Komuna e Ferizajt ndër komunat më të mëdhaja pa çerdhe publike, pra me këtë vendim ky banë çka dush, banë çfardush çmimi, kjo punë është hajgare edhe su dasht me pru fare këtë vendim.

**Amir Rexhepi** - Pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se unë se di cili është interesi i komunës me i dhanë këto çerdhe, kështu çmimi këtu do të jetë 100 euro apo drejtor, mirëpo kush na garanton neve që ky përfitues ka me i funksionalizu të gjitha, pasi ka vende ku ska me pasë interes d.m.th disa objekte janë demolu p.sh. në Lloshkobare, ky objekt përdoret për të pame, pra kem dilem që ska mu funksionalizu p.sh. pse se keni ba përmes subvencionimit p.sh. në Prishtinë kjo formë ka dështu.

**Jehona Mustafa** - Pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se konkretisht desha me pyet drejtorin a ka një plan konkret, a do të ketë letësime për fëmijët apo për prindërit që kanë 2 apo më shumë fëmijë dhe si do të paguhen punëtorët e KARITAS-it këtu ne në parim si grup parlamentar jemi kundër kësaj forme.

**Valon Aliu** - Pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se si kriter të jetë afati i funksionalizimit jo njëherë të ipen e pasataj të caktohen kriteret ju faleminderit.

**Arian Imeri** - Pasi përshëndeti të pranishmit unë sa i përket këtij propozimi besoj që të gjithë pajtohemi, që këto qerdhe nuk kanë funksionu d.m.th. ne kemi ndërto qerdhe, mirëpo nuk kanë funksionu, nuk është ajo që do të mbetet pa çerdhe publike, problemi kryesor është mungesa e stafit, ne kemi ba një zgjidhje me KARITAS, mirëpo ajo është e pa përballueshme në aspektin financiar, ne po e paraqesim me këtë vendim me ankand publik dhe besojë që kushdo që paraqitet prej sot mund te interesohet, sa i përket kushteve të ankandit mundemi gjithësecili me paraqit ide apo çkadoçoft për të funksionalizu këtë çështje sa më mirë. Unë kam disa propozime për shkak qe kjo marrëveshje nuk mund të kryhet para shtatorit ose kontrata të bëhet më herët, me prind ose kushdo që shpallet fitues mos të mund të ndryshohen kushtet që i kanë nënshkruar prindërit, propozoj edhe që këto objekte të mund të shfrytëzohen vetëm për këtë veprimtari sa i përket garancionit për punëtor të KARITAS-it do ta kërkoja edhe këtë garancion, unë po e shohë si një zgjidhje, këtyne spo ju pengon tenderat mbi 80 milion, ndërsa këtu po ju pengon ankandi publik



dhe meqense kjo është ankand, thirrni edhe ju dostat e juv pasi është ankand, madje në këtë komision do të ketë edhe zyrtar nga opozita.

**Shqipe Jashari** - Në bazë të kësaj rregllore d.m.th. ato që janë ndërtu për publike tani po bëhen publiko private e kështu me radhë, do të kërkoja cila do të jenë kriteret sa do të jetë nr. i fëmijëve nëpër klasa çfar paga do të kenë edukatorët, pika e 8-të thuhet që do të ketë afat 15 vjeçare, çka do të bëhet më pasë me këto edukatore pasi ka edukatore psh që kanë 12 vjetë stazh dhe çka do të ndodhë me këta?, largohen nga puna apo mund të vazhdohet apo do të ndodhë dhënia në shfrytëzim.

**Mimoza Sojeva** - Pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se sinqerisht është mjerim, kur një pjesë e asamblesë s'është këtu dhe kur kjo çështje është tejet e rëndësishme, një pjesë e grave s'mund edhe të punësohen për shkak që s'kanë ku me i dërgu fëmijët, pasi kjo çështje është mjerim se si ato objekte kanë mbet.

**Lumnije Morina** - Pasi përshëndeti të pranishmit kërkesa jonë ka qenë ndërtimi i çerdheve nga komuna dhe komuna e ka plotësuar këtë kërkesë, mirëpo ato nuk janë ba funksionale, të gjithë e dijmë që nuk lejohet marrja shtesë e punëtoreve dhe kështu këto kanë mbetë jashtë funksionimit dhe një prej alternativave na e kanë ofru sot egzekutivi dhe mendoj se është një alternativë e mirë, nuk është këtu mirë me paragjyku, pasi sipas disave këtu thuhet se është parashiku me ju dhanë dostave dhe s'kemi të drejt morale pa përfundu procesi, e më pas nëse ka vërejtje të vihen ato në shprehje, unë e mbështesë këtë propozim dhe uroj që të kaloj sa më mirë.

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Pyeti nëse ka dikush tjetër për të shtuar dhe pasi nuk pati korum kjo pikë u shtye për një seancë të radhës.

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Lexoi pikën e 11-të dhe e hapi debatin për këtë pikë, fjalën e mori Arbër Bytyqi ku theksoi se pronarit privat ju ka marrë që ta ruajmë si shesh, te sheshi fjala e lirë dhe ka ardhur kjo kërkesë për këmbim ashtu si është e paraqitur edhe në propozim vendim.

**Brahim Osmani** - Pasi përshëndeti të pranishmit, theksoi se e para kjo pikë s'është interes i komunës mas pari spe kuptojë, nëse u ndërtu një shesh si është ndërtu në pronë private spe kuptoj, si është ta ruajmë sheshin në pronë private, grupi jonë do të jetë kundër këtij vendimi, është mirë me kqyrë edhe kur është bo kjo pronë private.

**Amir Rexhepi** - Pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se ai që do të duhej të ishte këtu është Drejtori i pronës me monitor edhe me na tregu çka sakt është tu ndodhë, është mirë kjo pikë të shtyhet dhe të shikohet sakt.

**Flamur Istrefi** - Pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se edhe ne jemi kundër dhe propozoj të shtyhet pasi propozimi është nga personi në fjalë, zakonisht këto propozime vijnë nga komisioni dhe në këtë rast këtu kërkohet nga personi privat, këtu është se informacionet janë të pa mjaftueshme dhe këtu këmbimi vjen vetëm për pak metra, ndërsa këmbimi bëhet me 64 ari dhe nuk dihet sakt ku ka me ndodhë këmbimi.

**Arian Imeri** - Theksoi se ne pak a shumë duhet me ditë se për cilat prona bëhet fjalë, pasi në gjeoportali me numër sakt dihet, mirëpo po shihet që ju nuk keni konsistencë dhe nuk po di a e dini



që edhe ju keni kandidu për zgjedhje p.sh. na keni lodhë tu thanë mi ru hapsirat publike, parqet, pra aty ju ka lanë edhe emri dhe interesi përgjithshëm është me rujt pronën e parkut aty janë rreth 35 metra katror dhe propozimi është me ndru një pronë te kontrollera teknike në Talinoc të Jerlive dhe është shumë ma i madh interesi i komunës dhe në momentin që paraqitet çertifikata e pronës nuk ki çka mirresh me atë pjesë, pasi ajo përfitohet në procedurë të rregullt, unë e di pse jeni kundër që me u prish parku edhe me dal me thanë qe u prish parku thjesht jeni kundër çdo procesi që arrinë kjo qeveri.

**Brahim Osmani** - E para tha e kena ndërto parkun edhe e kem vendos emrin d.m.th. e kena caktu park pronën e huj madje edhe i kena vendos emër veç këqyri ndërtesat, ndërtimet edhe folni për të gjelbërtën, sa i përket qerdheve besoj që u konsumu debati.

**Arian Imeri** - Gjithë hapsira e parkut nuk është private, duhet me pas informacione pasi aty jo krejt prona është private është veç një pjesë.

**Flamur Istrefi** - Sa për skajrim s'jemi kundër parkut po flasim për një pjesë anësore nëse kishte qenë pjesë e parkut, ai s'kish mujt me marrë leje pasi drejtori po thotë që ai mund të merr leje po ati spi konvenon me maru aty në një ari dhe mund të këmbehet me nja 20 ari atje ku po donë mi marrë ju faleminderit.

**Amir Rexhepi** -Nuk jemi kundër hapsirave të gjelbërta, madje kemi propozu me u rritë buxheti për hapsira të gjelbërta, thjesht po kërkojmë që të shtyhet të vjen drejtori dhe të paraqes në detaje çka me çka është tu këmbu edhe rregullohet kjo çështje.

**Shqipe Jashari** - I nderum kolegë, një shprehje që më pengoj ku tha një katolik d.m.th. ska lidhje a është katolik a musliman, kjo far forme d.m.th. ndërton një park në pronë private si p.sh. në pronë time dhe vjen në kuvend dhe mundohet me të qitë para aktit të krym këtu edhe me thanë ja po don park, ja spo donë park.

**Arian Imeri** - Shqipja ka të drejt s'pata qëllim me ofendu sa i përket kësaj që tha Amiri, unë i kam pa në gjeoportali dhe parku është ndërto dhe është diçka që shifet aty.

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Theksoi që s'mundem pa e shpreh mendimin tim në parim edhe unë jam për me i ru parqet, por një çështje duhet të jetë e kjart, fillimisht nëse është park komuna mund të shpall interes të përgjithshëm, e tek më pas të bëhet këmbimi, këtu është e kundërta, këtu personi privat kërkon që të bëhet këmbimi, megjithat unë pajtohem si ta voton shumica, po najfar parku nuk është, e kam thënë edhe në KPF, nëse ka drejtë, nëse ipet leja, çka mi pengu, le t'i ipet, nëse jeni shku nëpër qytetet e mëdha të Europës në qendër ka ndërtim dhe parqet janë në periferi, megjithatë masi propozimi ka ardhë, une e hodhi në votim dhe kjo pikë nuk kaloi pasi ka 12 vota për, 14 abstenim.

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Lexoi pikën e 13 dhe pasi spati për të diskutuar kaloi me 28 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Lexoi edhe pikën e 14-të dhe këtu s'pati të interesuar për debat dhe kaloi me 28 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Ia kaloi fjalën Drejtorit Arbër Bytyqit i cili paraqiti plotësim ndryshimin për PZHK dhe theksoi se detajet janë në propozim, ministria ka kërku që këto ndryshimet të bëhen në këtë formë dhe kaloi me 28 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

**Arbër Bytyqi** - Paraqiti edhe propozimin për Sheshin “Adem Demaçi” dhe si është në propozim u hodh në votim dhe kaloi me 28 vota për.

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Lexoi një kërkesë të qytetarëve një petition për hapjen e një rruge e cila është në plan zhvillimor dhe kërkohet të mirrën hapat e shpronësimit pra në seancën tjetër është drejtori i obliguar që t’i paraqesë pronat që duhet të shpronësohen dhe kjo pikë kaloi me 28 për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Paraqiti edhe pikën e asetit për bartjen e asetit të Fabrikës së ujit, pra objektit të fabrikës së ujit, pra në kuadër të kompetencave, këto kompetenca bijen mbi kompanin e cila është “Bifurkacioni” që duhet te kihet parasysh që këtu bartet vetëm objekti, ndërsa prona mbetet ashtu si është.

**Mimoza Pajaziti** - Pyet drejtorin nëse është ndonjë marveshje se kur do të fillohet me ujin e pijëshëm a ka ndonjë marveshje?

Kjo pikë pasi u hodhë në votim kaloi me 27 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Tek pyetje dhe kërkesa a ka dikush diçka:

**Hatixhe Bungu** - Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, theksoi se kam një pyetje për Drejtorin e Shëndetësisë, sot i skadon kontrata punëtorëve të KARITAS-it, çka do të ndodhë me ta dhe kur do t’iu bëhet pagesa për punën që kanë bërë deri më sot, ska ditë që ata puntorë nuk na pyesin për këtë çështje dhe duhet që sot të na jepni një përgjigje për këtë çështje.

**Amir Rexhepi** - Për Drejtorin Arbër Bytyqi në Jezerc po zhvillohet asfaltimi i rrugicave, aty është ndryshu edhe paramasa, është ndryshu edhe rrugë, madje operatori ekonomik e ka dëmtu edhe kodrën dhe kërkojë nga ju që të na njoftoni?, a ka operatori ekonomik pëlqim për lejimin e asaj veprimtarie ju faleminderit?

**Arbër Bytyqi** - Këto janë leje që mirrën në ministri, ne s’kemi lëshu këso leje pasi s’kemi drejt.

**Brahim Osmani** - Desha të ndërlihdëm me Hatixhen, kur ka me u ba pagaesa për punëtorët e KARITAS-it dhe kur do të nënshkruhet kontrata, nuk ka të bëjë vetëm me kontratën kolektive, pasi raporti i auditimit i Vitit 2024 që mbi 2 milion euro janë nënshkru marrveshje pa mbulesë.

**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Pyeti nëse ka dikush tjetër pasi s’pati kalojmë në të ndryshme.

**Amir Rexhepi** - Mbasi e kem Arbërin këtu, po më intereson cili është interesi i komunës këtu mbrapa, po zhvillohet festivali përpos që i ka dhënë qytetit një hjeshi çka ka komuna interes pasi atyne që ju keni dhënë ata po i japin ato shtëpit e vogla me pagesë dhe këtu spo shohë ndonjë interes të komunës, andaj kërkoj nga ju që të na sqaroni çka konkretisht kemi patur, ne si interes këtu, pasi ne vetëm aty si komunë e pastrojme çdo ditë e gjithçka tjetër.



**Kryesuesi i KK-së Xhavit Zariqi** – Theksoi se të keni parasysh që jemi në të ndryshme dhe jo në pyetje dhe kërkesa dhe meqense nuk kemi tjerë të interesuar për këtë pikë e shpalli të mbyllur këtë seancë.

**Procesmbajtësi**



**Leutrim Mahmuti**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**



**Xhavit Zariqi**